



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.05-400/01-4717/22
Kaçanik: 28.02.2022

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 28 Shkurt 2022,
pos tjerash, u ;

INFORMUA

1. Lidhur me Raportin Vjetor Financiar për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
2. Në informatën ,si në pikën 1 të kësaj shkrese janë prezantuar Pasqyrat e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme të Buxhetit të Komunës së Kaçanikut ,për periudhën Janar – Dhjetor 2021.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është ; “Raporti Vjetor Financiar, për periudhën Janar – Dhjetor 2021” / Lënda 01Nr.05-400/01-4717/22.

Me këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Murseli





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Kaçaniku

Opština Kaçanik - Municipal Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 18.02.22	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
05	400/01-6777-1.	

RAPORTI VJETOR FINANCIAR

Per periudhën: Janar – Dhjetor

2021

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Për Kuvendin
Komunal-Publikun

Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi



Kaçanik, Shkurt 2022

I. Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2021:

Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2021 ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Organizata Buxhetore e Komunës së Kaçanikut – KO 652, gjatë këtij viti, ka vazhduar njëjtë së funksionari sikurse në vitin parapark, duke menaxhuar dhe operuar me mjete buxhetore në trembëdhjetë (13) Programe Buxhetore (PB):

1. Zyra e Kryetarit,
2. Administrata e Përgjithshme dhe Çështjet gjinore,
3. Zyra e Kuvendit Komunal,
4. Buxhet dhe Financa,
5. Shërbimet Publike dhe Emergjencat,
6. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural,
7. Planifikimi Urban dhe Mjedis,
8. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale,
9. Arsimit dhe shkenca,
10. Zyra Lokale për Komunitete,
11. Zhvillimi ekonomik,
12. Kultura, rinia dhe sportet dhe
13. Shërbimet sociale dhe rezidenciale.

Me qëllim të kompletimit sa më të mirë të këtij raporti, përmes dhënies së sqarimeve plotësuese mbi trendet e realizuara të mjeteve buxhetore për periudhën Janar – Dhjetor 2021 dhe krahasimit me periudhën e njëjtë të vitit parapark, në vazhdim bëjmë shpalosjen e Pasqyrave Financiare shtesë për dallim nga prezentimi i Pasqyrave derguar në MFPT, përmes tabelave të paraqitura në vijim:

RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR -DHJETOR 2021

TABELA 1: IMPLEMENTIMI I BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2021

TË HYRAT BUXHETORE		Buxheti i miratuar 2021	Buxheti i tanishëm 2021	Shpenzimet 31.12-2021	Shpenzimet 31.12-2020	Progresi në %	Krahasimi 2021/20 në €	Indeksi 2021/2020 (%)
		1	2	3	4	5=3/2	6=3-4	7=3/4
A	TOTAL FINANCIMI QEVERITAR	8,135,944.00	7,886,206.79	7,839,505.21	8,565,890.12	99.41	(726,384.91)	(8.48)
1	GRANTI I PËRGJITHSHËM	3,305,460.00	3,055,722.79	2,190,664.10	2,930,007.12	71.69	(739,343.02)	(25.23)
2	GRANTI I ARSIMIT	3,669,480.00	3,669,480.00	4,343,654.58	4,225,321.00	118.37	118,333.58	2.80
3	GRANTI I SHËNDETËSISË	1,161,004.00	1,161,004.00	1,305,186.53	1,410,562.00	112.42	(105,375.47)	(7.47)
B	TOTAL TE HYRAT VETANAKE- PARTICIPIMET DHE DONACIONET	646,655.00	1,200,187.25	814,115.97	459,579.88	67.83	354,536.09	77.14
4	TË HYRAT KOMUNALE TË VITIT 2021	646,655.00	646,655.00	404,743.86	302,733.98	62.59	102,009.88	33.70
5	TË HYRAT E BARTURA NGA VITI 2020	-	506,352.72	365,273.43	145,987.40	72.14	219,286.03	-
6	PARTICIPIMET DHE GRANTET E BARTURA NGA DONATORËT DHE HUAMARRJA	-	47,179.53	44,098.68	10,858.50	93.47	33,240.18	-
TOTALI (A+B)		8,782,599.00	9,086,394.04	8,653,621.18	9,025,470.00	95.24	(371,848.82)	(4.12)

Tabela 1 – pasqyrohet gjendja e Buxhetit të miratuar nga Kuvendi Komunal, Buxheti i Rishikuar në fillim të vitit me rastin e startimit të këtij viti buxhetor është bërë bartja definitive e të hyrave nga viti 2020, si bilance të pashpenzuara nga viti parapark, pastaj në kolonat vijuese janë pasqyruar shpenzimet aktuale sipas prerjes më **31.12.2021**, shkalla e realizimit të mjeteve buxhetore e shprehur në (%), si dhe prezentimi dhe *vënia në raport* e shpenzimeve të realizuara në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Buxheti fillestar i miratuar për vitin 2021 ishte në shumën totale prej **8,782,599.00 €**, ndërsa shuma prej **9,086,394.04€**, nga të dhënat e kolonës 2, ka të bëjë me ndryshimet apo buxhetin e shtuar gjatë këtij viti – buxheti aktual.

Në kolonën 3, është pasqyruar shpenzimi i mjeteve të përgjithshme gjatë kësaj periudhe të këtij vitit raportues prej **8,653,621.18€**.

Shikuar sipas burimeve të mjeteve, mjetet e shpenzuara nga granti qeveritar, nga gjithësej shuma prej 7,886,206.79€ është shpenzuar shuma prej 7,839,505.21€ apo një përmbushje buxhetore prej **99.41%**, ndërsa mospërmbushja prej vetem **0.59%** e mjeteve të Grantit Qeveritarë apo shuma prej 46,701.58€ kthehet suficit në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Ndërsa mjetet buxhetore nga të hyrave vetanake të vitit 2021 është shpenzuar shuma prej 404,743.86€ dhe të hyrat vetanake të bartura nga viti 2020, është shpenzuar shuma prej 365,273.43€ ose 72.14% dhe nga participimet, donatorët dhe huamarrjet shumë prej 44,098.68 ose 93.47%.

Në kolonën 4, kemi prezentuar shpenzimet e realizuar të periudhës së njëjtë të vitit 2020, të cilat janë në shumë prej **5,025,470.00€**, që sipas indeksave të realizuar, siç pasqyrohen në kolonën 6 dhe 7, shpenzimet e vitit 2021 në raport të njëjtë me ato të vitit paraparak, në këtë vit, shënojnë rënie për 4.12% apo shprehur në masë monetare prej 371,848.82€.

Përmes tabës së realizimit të të hyrave vetanake për vitin 2021, e cila do të paraqitet në vijim, do të shohim se nga gjithësej planifikimi i të hyrave direkte (tatimore dhe jotatimore) prej 646,655.00€ janë inkasuar 802,799.20€, pra kemi tejkalim shprehur në masë monetare të mjeteve prej 156,144.20 euro apo për 124.15% permbushja e planit vjetorë.

II. Raporti i inkasimit të të hyrave vetanake:

TABELA 2: RAPORTI I GRUMBULLIMIT TË TË HYRAVAE VETANAKE KOMUNALE SIPAS DREJTORIVE					
Emertimi i të hyrave vetanake	Planifikimi Janar-Dhjetor 2021	Realizimi: Janar Dhjetor 2021	Plani/Realizimi vjetorë (në %)	Realizimi: Janar-Dhjetor 2020	Krahasimi 2021 / 2020
Tatimi në pronë	264,705.00	261,315.14	98.72	239,237.57	22,077.57
Tatimi në tokë	60,000.00	113,477.91	189.13	24,249.31	89,228.60
Taksa nga rexhistrimi i automjeteve	50,000.00	61,795.00	123.59	55,660.00	6,135.00
Taksa nga ushtrimi i veprimtarisë	5,000.00	3,740.00	74.80	8,875.00	(5,135.00)
Taksa tjera	500.00	1,172.76	234.55	525.00	647.76
Gjobat nga inspektorati	1,500.00	1,880.00	125.33	1,020.00	860.00
Licencat pranim tekn.lokalit	500.00	-	-	350.00	(350.00)
Total: Buxhet dhe Financa	382,205.00	443,380.81	116.01	329,916.88	113,463.93
Taksa komunale për leje ndërtimi	60,000.00	114,729.47	191.22	85,352.67	29,376.80
Taksa për regjistrimin e trashigimisë	30,000.00	50,635.00	168.78	26,859.50	23,775.50
Taksa tjera Administrative	25,000.00	28,340.50	113.36	25,906.30	2,434.20
Taksa për leje mjedisore	10,000.00	12,746.25	127.46	-	12,746.25
Taksa për legalizimin e objekteve	30,000.00	29,196.44	97.32	-	29,196.44
Gjobat nga inspektorati	1,000.00	400.00	40.00	25.00	375.00
Shfrytëzimi i pronës publike	7,150.00	5,467.00	76.46	5,951.16	(484.16)
Taksa për matjen e tokës në teren	5,000.00	1,738.00	34.76	7,817.00	(6,079.00)
Total: Urbanizmi & Kadastrri	168,150.00	243,252.66	144.66	151,911.63	91,341.03
Shfrytëzimi publik për tregti të hapur (reklam)	10,000.00	16,978.22	169.78	3,362.66	13,615.56
Gjobat nga inspektorati	2,000.00	477.44	23.87	-	477.44
Taksa tjera Administrative	500.00	18.00	3.60	225.00	(207.00)
Total: Shërbimet Publike dhe Emergjencia	10,500.00	17,473.66	166.42	3,587.66	13,408.56
Taksa e Ndërrimit Destinimit të Tokës	33,500.00	28,692.70	85.65	7,661.25	21,031.45
Taksa për Shfrytëz. e Resurseve nat.	1,000.00	4,538.03	453.80	845.09	3,692.94
Taksa tjera	300.00	2,491.84	830.61	907.70	1,584.14
Total: Bujqësia dhe Pyltaria	34,800.00	35,722.57	102.65	9,414.04	26,308.53
Taksa e çertifikatave të lindjes	2,500.00	859.00	34.36	1,304.00	(445.00)
Taksa e çertifikatave të kurorëzimit	500.00	28.00	5.60	37.00	(9.00)
Taksa e çertifikatave të vdekjes	1,000.00	646.00	64.60	696.00	(50.00)
Taksa e çertifikatave tjera ofiçare	10,000.00	24,416.50	244.17	23,850.25	566.25
Taksa tjera Administrative	2,000.00	105.00	5.25	1,385.10	(1,280.10)
Taksa për shtetësi	1,000.00	-	-	5,201.55	(5,201.55)
Total: Administrata e Përgjithëshme	17,000.00	26,054.50	153.26	32,473.90	(6,419.40)

Taksa për çertifikata mjekësore	5,000.00	4,536.00	90.72	3,953.00	583.00
Gjobat nga inspektoriat	1,500.00	420.00	28.00	745.00	(325.00)
Licencat pranim teknik të lokaleve	500.00	40.00	8.00	-	40.00
Inspektimi i respektimit të planit Urb.	500.00	-	-	-	-
Inspektimi higjieniko-sanitarë	1,000.00	938.00	-	465.00	473.00
Participimet në shëndetësi	500.00	22.00	4.40	5,084.20	(5,062.20)
Total: Shëndetësia dhe M.S.	9,000.00	5,956.00	66.18	10,247.20	(4,291.20)
Participimet	25,000.00	30,959.00	123.84	24,187.00	6,772.00
Total: Arsimi dhe Kultura	25,000.00	30,959.00	123.84	24,187.00	6,772.00
GJITHSEJ TË HYRAT DIREKTE	646,655.00	802,799.20	124.15	561,738.31	241,060.89
Të hyrat nga gjobat e gjykatave	-	5,925.00		7,370.00	(1,445.00)
Të hyrat nga gjobat e trafikut	-	148,048.00		112,120.50	35,927.50
Të hyrat nga APK (Pylltaria)		13,133.72		11,022.01	2,111.71
TË HYRAT INDIREKTE	-	167,106.72		130,512.51	36,594.21
TOTALI I TË HYRAVE VETANAKE	646,655.00	969,905.92	149.99	692,250.82	277,655.10

Tabela 2 – pasqyron të dhënat e progresit të të hyrave vetjake si në raport me planin buxhetor, ashtu edhe në proporcion me periudhen e njëjtë të vitit paraprak, dhe atë:

- në kolonën e parë është pasqyruar plani vjetor i grumbullimit të të hyrave vetjake sipas llojit të tyre në shumë prej **646,655.00 €** (të hyrat direkte)
- në kolonën e dytë pasqyrohet shuma e mjeteve të grumbulluara për vitin 2021, të cilat janë në lartësi prej **802,799.20€** (te hyrat direkte) dhe shuma prej **167,106.72€** (te hyrat indirekte) apo totali prej **969,905.92€** (përfshirë të hyrat indirekte). Të hyrat Indirekte realizohen nga Institucionet tjera si: Gjykata, Policia dhe Agjensioni Pyjor i Kosovës, mirëpo i alokohen komunave për shfrytëzim bazuar në territorin e komunës në të cilin ka ndodhur aktiviteti i këtyre Institucioneve.
- në kolonën e tretë pasqyrohet përqindja e realizimit të planit buxhetor, e cila është **124.15%** e te hyrave direkte, ndërsa në kolonën e katërt paraqitet shuma e mjeteve prej **561,738.31 €** të realizuara gjatë vitit 2020 dhe në kolonën e pestë pasqyrohet raporti në mesë të hyrave të realizuara në vitin 2021, përballë atyre të realizuara në vitin e kaluar, e që tregohet një ritje e masës monetare prej **241,060.89€**.
- Bazuar në shpenzimet e treguara dhe shkallës së inkasimit të të hyrave vetanake për vitin 2021, në vijim, i'u paraqesim tabelën e shkëputur nga formati standard i Pasqyrave Financiare, e cila shpalosë shumat e bartura nga vitet paraprake, atyre te realizuara gjatë vitit 2021, shpenzimin e tyre gjatë vitit 2021 dhe ne fund mbetja për bartje në vitin 2022 në Buxhetin e Komunës së Kaçanikut. Shuma totale e kësaj bartje të të hyrave vetanake , e cila do të shfrytëzohet nga komuna gjatë këtij viti është **702,241.00 euro**.

Përshkrimi	2021	2020	2019
Të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar	506,353	263,423	285,701
Të hyrat vetanake të pranuar në këtë vit	969,906	702,510	703,545
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	1,476,259	965,933	989,247
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	(770,017)	(459,580)	(725,824)
Shuma e mbetur për bartje	706,241	506,353	263,423

Poashtu, përmes kësaj table janë të pasqyruara detajet e HVK-ve, sipas programeve buxhetore dhe sipas llojeve analitike të tyre. Kështu, nga Drejtoria e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit janë grumbulluar gjithsej: **443,380.81€** apo **55.23%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale, nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrit janë grumbulluar gjithesej mjete ne shumë prej: **243,252.66€** apo **30.30%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale, shuma tjetër e grumbullimit të mjeteve , është realizuar nga këto pesë (5) drejtori si ajo e: Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, shuma prej: **5,956.00€**, Administratës së Përgjithshme, shuma prej: **26,054.50€**, Arsimit, Kulturës shuma prej: **30,959.00€**, drejtoria e Bujqësisë, Plltarisë dhe Zhvillimit Rural, shuma prej: **35,722.57€** dhe drejtoria e Shërbimeve Publike, shuma prej: **17,473.66€** që së bashku përbëjnë **14.47%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.

Ndërsa, sipas llojit të të hyrave direkte, rezultate më të mira kemi te të hyrat e tatimit ne pronë dhe tokë, lejeve të ndërtimit, taksave per regjistrimin e trashigimisë, ku kemi tejkallim te planifikimeve, etj.

III . Shpenzimet e realizuara për periudhën Janar – Dhjetor 2021:

Dinamika e shpenzimeve për këtë periudhë është realizuar me **95.24%** në raport me Buxhetin aktual (të ndryshuar) apo shuma prej **8,653,621.18€** ndërsa krahasuar më periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shkallën e shpenzimit prej **4.12%** më të ulët apo shumën prej **371,848.82€**.

Tabela 3. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik								
KATEGORITE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE (KESH)		Buxheti Aktual 2021	Shpenzimet e realizuara 31.12.2021	Shpenzimet e realizuara 31.12.2020	Progresi përball plan. buxhetor	Krahasimi: Buxheti - Shpenzimet	Krahasimi 2021 / 2020 në €	Krahasimi 2021 / 2020 në %
		1	2	3	4=2/1	5=1-2	6=2-3	7=2/3
1	Pagat dhe medijtjet	5,058,047.77	5,058,047.77	5,232,500.00	100.00	-	(174,452.23)	(3.33)
2	Mallrat dhe shërbimet	846,214.50	826,344.13	1,725,420.00	97.65	19,870.37	(899,075.87)	(52.11)
3	Shpenzimet komunale	204,964.00	188,596.87	183,230.00	92.01	16,367.13	5,366.87	2.93
4	Subvencionet dhe transferet	304,188.60	300,804.00	230,240.00	98.89	3,384.60	70,564.00	30.65
5	Shpenzimet kapitale	2,672,979.17	2,279,828.41	1,654,080.00	85.29	393,150.76	625,748.41	37.83
TOTALI (1 deri 5)		9,086,394.04	8,653,621.18	9,025,470.00	95.24	432,772.86	(371,848.82)	(4.12)

Tabela 3 – paraqet shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik në nivel të Organizatës buxhetore përballë planifikimit buxhetor dhe shpenzimeve të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit paraprak, dhe ate:

- Pagat dhe Mëditjet janë realizuar për 100%, ndërsa në raport me 2020, kemi një ulje të shpenzimeve për 3.33%;
- Mallërat dhe Shërbimet janë realizuar për 97.65%, ose një ulje për 52.11%;
- Shërbimet Komunale janë realizuar për 92.01%, ose një rritje për 2.93%;
- Subvencione dhe Transferet janë realizuar për 98.89%, ose një rritje për 30.65%; dhe
- Shpenzimet kapitale janë realizuar për 85.29%, ose një rritje për 37.83% në krahasim me vitin 2020.

Tabela 4. PROGRESI I SHPENZIMEVE									
NR	PROGRAMET BUXHETORE (11)	Stafi i lejuar	Pagat dhe mëditje	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Totali	Struktura në % sipas (PB)
1	Zyra e kryetarit	25	175,115.88	24,552.45	-	30,000.00	-	229,668.33	2.65
2	Administrata e përgjithshme	25	122,240.10	48,242.17	10,999.99	-	13,910.00	195,392.26	2.26
3	Zyra e kuvendit komunal	0	85,398.06	14,981.75	-	-	-	100,379.81	1.16
4	Buxhet, financa zhv. Ek	18	60,361.94	9,997.44	-	8,800.00	161,481.87	240,641.25	2.78
5	Shërbimet publike dhe emergjenca	31	206,414.05	281,737.07	51,984.10	43,260.00	761,706.03	1,345,101.25	15.54
6	ZLK	1	8,418.09	1,000.00	-	-	-	9,418.09	-
7	Bujqesia, Pylltaria dhe ZHR	15	61,244.86	20,358.51	-	105,846.00	48,302.44	235,751.81	2.72
8	Planifikim urban dhe mjedisi	16	70,606.21	33,871.85	-	-	548,949.19	653,427.25	7.55
	ADMINISTRATA KOMUNALE	131	789,799	434,741	62,984	187,906	1,534,350	3,009,780.05	34.78
9	Shëndetësia dhe mireqenia soc.	117	838,172.40	103,030.85	52,819.23	5,000.00	301,164.05	1,300,186.53	15.02
10	Arsimi dhe kultura	557	3,430,076.18	288,572.04	72,793.55	107,898.00	444,314.81	4,343,654.58	50.19
	TOTALI (1 deri 11)	805	5,058,047.77	826,344.13	188,596.87	300,804.00	2,279,828.39	8,653,621.16	100.00
	Struktura në % sipas (KESH)		58.45	9.55	2.18	3.48	26.35	100.00	

Tabela 4 – kemi pasqyruar progresin e shpenzimeve aktuale sipas programeve buxhetore dhe klasifikimit ekonomik, dhe pjesëmarrja e tyre në strukturën e gjithmbarëshme të shpenzimeve të realizuara për periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2021.

Pagat dhe Mëditjet, në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve marrin pjesë me 58.45%, Mallërat dhe Shërbimet, me 9.55%, Shërbimet Komunale me 2.18%, Subvencionet dhe Transferet me 3.48%, ndërsa Shpenzime për Investime Kapitale, me 26.35%.

- ***Në vijim janë paraqitur shpenzimet analitike sipas kodeve ekonomike dhe programeve buxhetore për kategorinë e mallrave & shërbimeve, subvencioneve & transfereve dhe investimeve kapitale:***

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE NË MALLËRA DHE SHËRBIME											Sipas gjendjes më 31.12.2021		
MALLËRAT DHE SHËRBIMET	Zyra e Kryetarit	Zyra e Kuvendit Komunal	Administrata e Përgjithshme	Buxhet,Financa dhe Zhv.Ekonomik	Sherbimet Publike	Bujqësia, Pylfitoria e ZHR	Urbanizmi dhe Kadastrë	Arsimi dhe Kultura	Shëndetësia dhe MS	Totali 2021	Totali 2020	Dallimi ne EURO	
KESH													
13130 UDHËTIMET ZYRTARE BRENDA VENDIT											3,430	(3,430)	
13140 UDHËTIMET ZYRTARE JASHTË VENDIT											970	350	
13310 SHPENZIMET E INTERNETIT			6,122.53	40.32		410.08	10.08	900.00		1,320	5,240	1,510	
13320 SHPENZIMET E TELEFONISË MOBILE			40.00				587.52			40	50	(10)	
13330 SHPENZIMET POSTARE								1,250.00		1,250	5,960	2,560	
13410 SHPENZIMET E ARSIMIT E TRAJNIMIT									97.94	8,520	1,117	(805)	
13420 SHLE PERFAQESIMIT DHE AVOKATURËS	322.14					8,099.52			2,337.02	4,965	1,293	1,100	
13430 SHËRBIMET E NDRYSHME SHËNDETËSORE				1,470.00		250.00	1,185.00	500.00		1,105.07	126,198	11,068	
13440 SHËRBIMET E NDRYSHME Intelektuale-krëstimthënë	1,560.00			20.00				1,100.00		1,100	6,001	38,850	
13450 SHPENZIMET e shlyties-tomarketing	167.50										43,589		
13470 SHPENZIMET E SHËRBIMEVE TEKNIKE											17,314	(20,566)	
13480 SHPENZIMET E SHËRBIMEVE KONTRAKTUES	3,535.00	4,660.00	13,847.40	3,948.30	20,325.20	1,390.00	9,800.98	46,532.60	22,159.00	115,130	4,330	1,671	
13490 SHPENZIMET PËR ANËTARSIM	6,001.35									38,850			
13501 SHPENZIMET E MOBILJEVE								43,289.37	300.00	43,589			
13502 TELEFONA (Më pak se 1,000 euro)													
13503 SHPENZIMET E KOMPJUTERAVE		7,487.86						9,846.00					
13504 HUARDER PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE													
13505 MAKINA FOTOKOPJUESE													
13556 SHPENZIMET E PAISJES SPECIALE MJEKËSORE													
13509 SHPENZIMET E PAISJEVE T.JERA <1000	650.00		2,110.00	1,400.00	1,041.50		4,648.00	26,203.66	4,580.00	40,633	15,680	24,953	
13610 SHPENZIMET E FURNIZIMIT PËR ZYRË	3,655.30	181.00	1,504.69	1,704.98	1,070.76		3,317.28	15,698.49	7,928.60	35,061	34,000	1,061	
13620 SHPENZIMET E FURNIZIMIT ME USHOIM E PIJË	6,271.16	2,262.39	1,364.70	942.40	2,953.60	724.90	7,621.20	11,415.56	2,649.80	36,206	84,750	(48,544)	
13630 SHPENZIMET E FURNIZIMEVE MJEKËSORE									21,781.74	21,782	47,680	(25,898)	
13640 SHPENZIMET E FURNIZIMEVE HIGJENIKE			780.50		282.75			6,027.97	1,096.00	8,187	11,000	(2,813)	
13660 SHPENZ E FURNIZIMEVE ME VESHMBATHJE								980.00		980	8,040	(7,060)	
13710 SHPENZIMET E VAJIT													
13720 SHPENZIMET E NAFTËS PËR NGROHJE			48.40							48	3,950	(3,902)	
13730 VAJ PËR NGROHJE													
13750 SHPENZIMET E QYMIRIT													
13760 SHPENZIMET E DRUVE PËR NXEMJE	7,496.35							85,863.55	6,149.00	99,509	103,240	(3,731)	
13780 SHPENZIMET E DERIVATEVE PËR VETURA	9,505.96				3,584.63	4,327.12	1,678.98	188.34	11,615.81	30,901	27,250	3,651	
13770 SHPENZ. E DERIVATEVE PËR GJENERATOR	237.66							11,652.56	3,167.79	15,058	2,390	12,668	
13911 PROVIZIONI - NLB	198.00									198	140	58	
13960 REGJISTRIMI & SIGURIMI I AUTOMJETEVE	970.81		2,952.53		2,177.81	1,019.68	224.25	625.00	4,297.85	12,268	11,310	958	
13953 SIGURIMI I NDERTESAVE DHE DHE T.JERA													
14010 MIRËMBAJTJA E RIPARIMI I AUTOMJETEVE	470.49		2,329.00		1,267.00	3,006.50	952.00	449.00	4,988.30	13,462	16,410	(2,948)	
14020 MIRËMBAJTJA E RIPARIMI I NDERTESAVE			175.40		127.50	23.50	62.20	1,598.00	1,015.00	3,002	10,180	(7,178)	
14023 MIRËMBAJTJA E SHKOLLAVE								21,158.33		21,158	6,710	14,448	
14032 MIRËMBAJTJA E AUTO RRUQËVE LOKALE					229,307.34		3,784.36			233,092	357,460	(124,368)	
14040 MIRËMB E TEKNOLOGJISE INFORMATIVE											680	(680)	
14050 MIRËMBAJTJA E MOBILJEVE DHE PAISJES	120.00				384.78			1,406.04	8,757.00	10,668	16,500	(5,832)	
14060 MIRËMBAJTJA RUTINORE					18,869.70					18,870	70	1,129	
14130 QERAJA - PAJISJET			727.05	471.54						1,199			
14210 REKLAMAT DHE KONKURSET													
14230 SHPENZIMET PËR INFORMIM PUBLIK													
14220 BOTIMET E PUBLIKIMEVE													
14310 DREKAT ZYRTARE	630.70	350.00			344.50	542.00		600.00		600	700	600	
14410 SHPENZIMET E VENDIMEVE TË GJYKATAVE		60.50				565.21		182.50	110.00	2,160	740,540.00	(739,914)	
TOTALI I SHPENZIMEVE :	24,552.45	14,981.75	49,242.17	9,997.44	281,737.07	20,368.51	33,871.85	288,572.04	103,030.85	826,344	1,775,410	(899,066)	
	2.97	1.81	5.96	1.21	34.09	2.46	4.10	34.92	12.47	100.00			
	Struktura e pjesëmarrjes												

SUBVENCIONET DHE TRANSFERET		
SHPENZIMI PËR PERIUdhËN: JANAR-DHJETORË 2021		
Prog.	Përshkrimi	Buxheti 2021
1	2	3
16028	Zyra e Kryetarit	30,000
18028	Drejtoria e Shërbimeve Publike	42,960
48028	Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit Ekonomik	10,000
47028	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zh.R	85,000
73037	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mbrojtja Sociale (MS)	5,000
85028	Kultura, Rinia dhe Sporti	62,663
92140	Arsimi dhe Kultura	50,040
Totali:		285,663.34

Subvencionet dhe Transferet - ndarja në detaje

Nr. Rend.	Përshkrimi	Realizimi Janar - Dhjetorë 2021
I.	ZYRA E KRYETARIT	30,000.00
1	PAGESA PER PERFITUES INDIVIDUAL-NDIHMA QASTI	6,100.00
2	PAGESA QYTETARËVE PËR NDËRTIMIN E SHËTËPIVE (500€ PËR SECILIN RAST)	6,500.00
3	OVL E UÇK - SË	3,000.00
4	OKPIP KAÇANIK	500.00
5	SHPAK HK (HANDIKOS KAÇANIK)	7,500.00
6	SUBVENCIONIMI I NDERMARRJEVE TRANSPORTUESE LOKALE	6,400.00
II.	DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE	43,260.00
1	BIK-KAÇANIK (pagesat për rastet mortore)	43,260.00
	PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK	8,800.00
1	SUBVENCIONIMI I NDERMARRJEVE TRANSPORTUESE LOKALE	8,800.00
III.	DREJTORIA E BUJQËSISË & PYLLTARISË	105,846.00
1	Subvencionimi i qytetarëve me serra përmes participimit (80% Komuna; 20% përfituesi)	105,846.00
IV.	DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE M.SOCIALE	5,000.00
1	PAGESA PER PERFITUES INDIVIDUAL	5,000.00

V.	DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS	111,282.60
1	TRANSPORTI I NXENESEVE PER KATEGORITE E NDRYSHME	29,993.00
2	PAGESA E BURSIVE PER STUDENTE	20,000.00
3	KF LEPENCI	15,960.00
4	FONDACIONI BONEVET KAÇANIK	2,000.00
5	KB KAÇANIKU	2,800.00
6	KFFBBK	2,500.00
7	KLUBI HENDBOLLIT LEPENCI	2,000.00
8	KLUBI MUNDJES KAÇANIKU	1,200.00
9	KLUBI TAEKWONDO KAÇANIKU	1,500.00
10	KLUBI I VOLEJBOLLIT KAÇANIKU	1,800.00
11	KVK FEMRAT	1,800.00
12	KVRL KAÇANIK	1,400.00
13	MOTOKROSS KAÇANIKU	1,000.00
14	QK KAÇANIKU	3,500.00
15	SHBA KAÇANIKU 2015	1,000.00
16	SHKA TINGUJT E VENDLINDJES	6,500.00
17	SHOQ.KULTURORE ARTISTIKE GRYKA E KAÇANIKUT	3,500.00
18	HUMANIZMI FFSH	500.00
19	SHOQATA E PESHK. SPOR. REKREA. "TROFTA E LEPENCIT"	1,000.00
20	FINANCIMI I AKTIVITETEVE TJERA KULTURORE, SPORTIVE	10,129.60
21	SHPKFSSHK KAÇANIK	1,200.00
Totali (I+II+III+IV):		304,188.60

REALIZIMI I PROJEKTEVE KAPITLAE JANAR - DHJETORË 2021:

KODI - PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT	PLANIFIKIMI	SHPENZIMI	MBETJET E LIRA	PROGRESI NË %
TOTALI I FINANCIMIT DHE SHPENZIMIT SIPAS GJITHA FONDEVE	2,672,979.17	2,279,828.41	393,150.76	85.29
04 FINANCIMET NGA HUAMARRJET	3,550.00	3,550.00	0.00	100.00
ARSIMI FILLOR - KAÇANIK	3,550.00	3,550.00	0.00	
42130 MJETE KOKRETIZIMI,PAISJE TEKNOLOGJISE INFORMATIVE-KACANIK	3,550.00	3,550.00	0.00	100.00
FINANCIMI NGA GRANTI QEVERTARË	1,829,197.00	1,792,806.61	36,390.39	98.01
DREJTORIA E FINANCAVE	130,000.00	129,996.23	3.77	100.00
43973 Mjetet për shpronësime	30,000.00	30,000.00	0.00	100.00
86245 BASHKFINANÇIM I PROJEKTEVE	100,000.00	99,996.23	3.77	100.00
18028 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE	694,551.00	694,143.43	407.57	99.94
45490 NDËRTIMI I RRJETEVE TË UJËSJELLËSEVE	97,000.00	96,995.74	4.26	100.00
46564 RREGULLIMI I TROTUARIT NE RRUGEN BOB-DOGANAJ	95,000.00	95,000.00	0.00	100.00
46633 RREGULLIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK	95,000.00	95,000.00	0.00	100.00
48281 ASFALTIMI I RRUGES RAMADAN XHOKLI - KOXHAJ	45,000.00	45,000.00	0.00	100.00
50161 ASFALTIMI I RRUGES NE LAGJET DALLOSHI, MURSELI DHE CENA-DOGA	40,000.00	40,000.00	0.00	100.00
51033 NDERTIMI I TROTUARIT NE RRUGEN HETEM HASAJ DHE AVDYL DURAJ	45,000.00	45,000.00	0.00	100.00
51036 RREGULLIMI I SHESHIT TE QYTETIT - FAZA I-RË	35,000.00	34,600.00	400.00	98.86
51042 REHABILITIMI I RRUGES QAMIL ILAZI DHE SALI BAJRA	145,000.00	145,000.00	0.00	100.00
88641 NDERTIMI I KANALIZIMEVE FEKALE DHE ATMOSFERIKE	97,551.00	97,547.69	3.31	100.00
47028 BUJQËSIA - KAÇANIK	50,000.00	48,302.44	1,697.56	96.60
86251 PROJ ZHVILL BUJQS-BLEGT	50,000.00	48,302.44	1,697.56	96.60
66445 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - KAÇANIK	519,646.00	492,806.98	26,839.02	94.84
46807 RRENIMI I OBJ. DHE LARGIMI I DEPONIMEVE ILEGALE	15,000.00	15,000.00	0.00	100.00
50199 NDËRTIMI I SHTRËTËRVE TË LUMENJËVE DHE PËRROCKAVE	45,000.00	45,000.00	0.00	100.00
50200 RENOVIMI I OBJEKTEVE BANESORE KOLEKTIVE	20,000.00	20,000.00	0.00	100.00
50201 RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJESËN URBANE DHE RURA	234,646.00	234,634.48	11.52	100.00
51213 NDERTIMI DHE RREGULLIMI I QARSHISE SE VJETER TE QYTETIT	180,000.00	153,172.50	26,827.50	85.10
86254 HARTIMI PROJEKTEVE	25,000.00	25,000.00	0.00	100.00

74700 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - KAÇANIK	155,000.00	147,810.05	7,189.95	95.36
46820 RENOVIMI I OBJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURËS SHËNDETËSORE	30,000.00	25,948.77	4,051.23	86.50
50208 RINDËRTIMI I OBJEKTIT TË QMF-SË NË FSHATIN DOGANAJ-KAÇANIK	85,000.00	81,861.28	3,138.72	96.31
88642 FURNIZIM ME MOBILJE DHE PAJIME NË QKMF	40,000.00	40,000.00	0.00	100.00
85028 SHËRBIMET KULTURORE - KAÇANIK	30,000.00	30,000.00	0.00	100.00
48562 RENOVIMI I OBJEKTIT TE SHTEPISË SË KULTURËS 'XHELADIN KURTAJ	10,000.00	10,000.00	0.00	100.00
51025 NDERTIMI I MEMORIALIT PËR VIKTIMAT CIVILE TË LUFTËS	20,000.00	20,000.00	0.00	100.00
92140 ADMINISTRATA - KAÇANIK	250,000.00	249,747.48	252.52	99.90
48671 RREGULLIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I KABINETEVE SHKOLLORE	20,000.00	19,747.48	252.52	98.74
51046 NDERTIMI I SALLES SE EDUKATES FIZIKE NE SHFMU 7 SHTATORI BEG	150,000.00	150,000.00	0.00	100.00
86263 RENOVIMI I OBJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURES SHKOLLORE	70,000.00	70,000.00	0.00	100.00
88649 FURNIZIM ME MOBILJE DHE PAJIME TE SHKOLLAVE	10,000.00	10,000.00	0.00	100.00
21 TE HYRAT VETANAKE	384,004.00	167,579.94	216,424.06	43.64
16328 ADMINISTRATA - KAÇANIK	15,000.00	3,910.00	11,090.00	26.07
50993 NDËRTIMI I ANEKSIT TË OBJEKTIT TË ADMINISTRATËS KOMUNALE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
50995 NDERTIMI I PARKINGUT NENTOKËSORË PËR ADMINISTRATËS KOMUNALE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
86246 Furnizim me Mobilje dhe Pajime	5,000.00	3,910.00	1,090.00	78.20
18028 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE	81,000.00	16,792.56	64,207.44	20.73
43987 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës së fshatrave Llanishtë	2,500.00	0.00	2,500.00	0.00
45490 NDËRTIMI I RRJETEVE TË UJËSJELLËSEVE	3,000.00	1,579.85	1,420.15	52.66
46554 RREG.I RRUGES BOB-KULLA HASANIT	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
46564 RREGULLIMI I TROTUARIT NE RRUGEN BOB-DOGANAJ	5,000.00	2,501.23	2,498.77	50.02
46633 RREGULLIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
48243 RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NDËRKOMUNALE	2,500.00	0.00	2,500.00	0.00
48261 NDERTIMI I IMPIANTIT PER TRAJTIMIN E UJRAVE TË ZEZA	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
48264 NDERTIMI DHE RREGULLIMI I PARQEVE PUBLIKE	5,000.00	2,841.80	2,158.20	56.84
48281 ASFALTIMI I RRUGES RAMADAN XHOKLI - KOXHAJ	5,000.00	5,000.00	0.00	100.00
50161 ASFALTIMI I RRUGES NE LAGJET DALLOSHI, MURSELI DHE CENA-DOGA	10,000.00	319.56	9,680.44	3.20
50170 NDERTIMI I OBJEKTIT PER ZJARREFIKESIT - KAÇANIK	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
51009 ASFALTIMI I RRUGES QË LIDHË FSHATRAT KOTLINË-IVAJË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
51013 NDËRTIMI I STAZËS PËR KËMBËSOR DHE SHTEGUT PËR BICIKLISTA PË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
51033 NDERTIMI I TROTUARIT NE RRUGEN HETEM HASAJ DHE AVDYL DURAJ	5,000.00	3,788.64	1,211.36	75.77
51042 REHABILITIMI I RRUGES QAMIL ILAZI DHE SALI BAJRA	5,000.00	266.70	4,733.30	5.33

51045 NDERTIMI I KOLEKTORIT KRYESORË PER TRAJTIMIN E UJRAVE TE ZEZ	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
88641 NDERTIMI I KANALIZIMEVE FEKALE DHE ATMOSFERIKE	3,000.00	494.78	2,505.22	16.49
48028 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - KAÇANIK	58,076.00	7,840.63	50,235.37	13.50
45309 NDERTIMI I INFRASTRUKTURËS NË ZONAT INDUSTRIALE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
45338 PROJEKTE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT	50,000.00	7,840.63	42,159.37	15.68
48305 NDËRTIMI I KANALIZIMEVE FEKALE NE ZONËN TURISTIKE SHTRAZË	3,076.00	0.00	3,076.00	0.00
66445 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - KAÇANIK	49,928.00	10,019.42	39,908.58	20.07
46807 RRENIMI I OBJ. DHE LARGIMI I DEPONIMEVE ILEGALE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
48413 RREGULLIMI DHE ASFALTIMI RR.GËRLICË-K.VJETËR-STAGOVË-RUNJEVË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
50199 NDËRTIMI I SHTRËTËRVE TË LUMENJËVE DHE PËRROCKAVE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
50201 RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJESËN URBANE DHE RURA	4,928.00	916.69	4,011.31	18.60
51213 NDERTIMI DHE RREGULLIMI I QARSHISE SE VJETER TE QYTETIT	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
86253 HARTIMI PLAN RREGULLATIVE	5,000.00	4,102.73	897.27	82.05
86254 HARTIMI PROJEKTEVE	5,000.00	5,000.00	0.00	100.00
74700 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
48554 BLËRJA E VETURAVE PËR NEVOJA TË QKMF-SË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
50208 RINDËRTIMI I OBJKTIT TË QMF-SË NË FSHATIN DOGANAJ-KAÇANIK	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
88642 FURNIZIM ME MOBILJE DHE PAJIME NË QKMF	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
75636 SHERBIMET SOCIALE-KACANIK	50,000.00	50,000.00	0.00	100.00
51214 NDERTIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I OBJKTEVE PER BANIM SOCIAL	50,000.00	50,000.00	0.00	100.00
85028 SHËRBIMET KULTURORE - KAÇANIK	20,000.00	10,063.18	9,936.82	50.32
45084 NDËRTIMI DHE RIVITALIZIMI I MONUMENTEVE KULTURO-HISTORIKE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
45087 RREGULLIMI VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE VETERANËVE TË UÇK-SË	10,000.00	9,000.00	1,000.00	90.00
48562 RENOVIMI I OBJKTIT TE SHTEPISË SË KULTURËS 'XHELADIN KURTAJ	5,000.00	1,063.18	3,936.82	21.26
92140 ADMINISTRATA - KAÇANIK	95,000.00	68,954.15	26,045.85	72.58
50210 NDERTIMI I SALLAVE TË EDUKATËS FIZIKE NE SHFMU: NAZMI OSMAN	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
50211 NDERTIMI I SHFMU - EMIN DURAKU- KAÇANIK	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
50212 NDETIMI I ANEKSIT NE GJIMNAZIN SKENDERBEU KAÇANIK	5,000.00	1,185.53	3,814.47	23.71
51046 NDERTIMI I SALLES SE EDUKATES FIZIKE NE SHFMU 7 SHTATORI BEG	50,000.00	50,000.00	0.00	100.00
86263 RENOVIMI I OBJKTEVE DHE INFRASTRUKTURES SHKOLLORE	30,000.00	17,768.62	12,231.38	59.23

22 TË HYRAT VETANAKE- 2020	453,647.32	315,891.86	137,755.46	69.63
16328 ADMINISTRATA - KAÇANIK	10,000.00	10,000.00	0.00	100.00
86246 Furnizim me Mobilje dhe Pajime	10,000.00	10,000.00	0.00	100.00
DREJTORIA E FINANCAVE	70,000.00	23,645.01	46,354.99	33.78
86245 BASHKFINANCIM I PROJEKTEVE	70,000.00	23,645.01	46,354.99	33.78
18028 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE - KAÇANIK	80,000.00	50,770.04	29,229.96	63.46
45490 NDËRTIMI I RRJETEVE TË UJËSJELLËSEVE	10,000.00	10,000.00	0.00	100.00
46633 RREGULLIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK	10,000.00	5,903.78	4,096.22	59.04
48264 NDERTIMI DHE RREGULLIMI I PARQEVE PUBLIKE	10,000.00	10,000.00	0.00	100.00
48281 ASFALTIMI I RRUGES RAMADAN XHOKLI - KOXHAJ	35,000.00	24,866.26	10,133.74	71.05
88641 NDERTIMI I KANALIZIMEVE FEKALE DHE ATMOSFERIKE	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
66445 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - KAÇANIK	101,647.32	46,122.79	55,524.53	45.38
50199 NDËRTIMI I SHTRËTËRVE TË LUMENJËVE DHE PËRROCKAVE	18,000.00	180.78	17,819.22	1.00
50200 RENOVIMI I OBJEKTEVE BANESORE KOLEKTIVE	50,000.00	45,593.06	4,406.94	91.19
50201 RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJESËN URBANE DHE RURA	23,647.32	348.95	23,298.37	1.48
86254 HARTIMI PROJEKTEVE	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
75636 SHERBIMET SOCIALE-KAÇANIK	110,000.00	103,354.02	6,645.98	93.96
51214 NDERTIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I OBJEKTEVE PER BANIM SOCIAL	110,000.00	103,354.02	6,645.98	93.96
85028 SHËRBIMET KULTURORE - KAÇANIK	10,000.00	10,000.00	0.00	100.00
48562 RENOVIMI I OBJEKTIT TE SHITESË SË KULTURËS 'XHELADIN KURTAJ	10,000.00	10,000.00	0.00	100.00
92140 ADMINISTRATA - KAÇANIK	72,000.00	72,000.00	0.00	100.00
86263 RENOVIMI I OBJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURES SHKOLLORE	72,000.00	72,000.00	0.00	100.00
31 GRANT I DONAT.TË MBRENDSHËM	160.85	0.00	160.85	0.00
16028 ZYRA E KRYETARIT - KAÇANIK	54.85	0.00	54.85	0.00
70942 ASFALTIMI I RRUGES L.LEKAJ-DOGANAJ	54.85	0.00	54.85	0.00
47028 BUJQËSIA - KAÇANIK	106.00	0.00	106.00	0.00
72341 PARTICIPIMI ME QYTETARET	14.00	0.00	14.00	0.00
86251 PROJ ZHVILL BUJQS-BLEGT	92.00	0.00	92.00	0.00
39 KRYQI I KUQ	2,400.00	0.00	2,400.00	0.00
95010 ARSIMI I MESEM - KAÇANIK	2,400.00	0.00	2,400.00	0.00
93902 TRAJNIM TË RINJËVE	2,400.00	0.00	2,400.00	0.00



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Emri i organizatës buxhetore në gjuhën shqipe
Emri i organizatës buxhetore në gjuhën serbe

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021

Statuti dhe i Organizatës Buxhetore
REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KACANIKUT
OPŠTINA KACANIK

31.01.22		EAS/1417
Nr. Org.	Nazimi	Shtetësi
01	hoo/or-2976	Y.

Prishtinë, 31.01.2022
Ministria e Financave / Ministarstvo Finansija
Ministry of Finance
Treasori - Trezor - Trzori

Prishtinë, 31.01.2022

584

PRISTINE

Neni 12

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **AHMET ISMAILI, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit**

Nga: **Besim Ilazi, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

Gafurr Loku, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2021.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huatë e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 të institucionit Komuna e Kaçanikut.

Data: 31/01/2022

(Nënshkrimi i ZKA)



Faqe - 2 - nga 37

Datë: 31/01/2022

(Nënshkrimi i ZKF)

Neni 13

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

	Llogaria e vetme e Thesarit		Llogaria e vetme e Thesarit		Llogaria e vetme e Thesarit	
	BKK	'000	BKK	'000	BKK	'000
Shënim						
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET						
Granti qeveritar	7,839.51		8,499.49		7,346.66	
Të hyrat vetanake	770.02		448.72		720.37	
Të hyrat e dedikuara						
Të hyrat nga AKP	21.17		10.86		6.01	
Grantet e përcaktuara të donatorëve	22.93					
Financimet nga luamarrja						
Klauzola e investimeve						
Fondi zhvillimor në mirëbesim						
Pranimet tjera			66.83		38.48	
Gjithsej	8,653.62		9,025.90		8,111.52	
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT						
Operacionet						
Paga dhe shtesa	5,058.05		5,232.50		4,959.25	
Mallra dhe shërbime	826.34		1,725.42		824.64	
Shpenzime komunale	188.60		183.23		140.48	
	6,072.99		7,141.15		5,924.37	
Transferet						
Transfere dhe subvencione	300.80		230.24		215.42	
Shpenzime kapitale						
Frona, ndërtesa dhe pajtise	2,279.83		1,654.08		1,971.73	
Pagesa tjera						
Gjithsej	8,653.62		9,025.47		8,111.52	

Shënim: Pagesat nga palët e treta prezantohen në shënimin 13 në përputhje me SNKPS 2017, efektive nga 1 janari 2019.

- Shuma e paraqitur prej 22,929.48 euro i perket shpenzimit nga fondi 04 Huamarrja e cila është dedikuar per sektorin e Arsimit, ndersa shuma prej 21,169.20 euro i perket shpenzimit te mjeteve nga fondi 31-GPD-participimet e fermerëve per projektin e paisjes me serra.

Neni 14
Raporti i ekzekutimit te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Komunën e Kaçanikut
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021

Shënime	2021						2020	2019
	Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Varianca	Realizimi	Realizimi		
	A € '000	B € '000	C € '000	D=B-A € '000	E € '000	F € '000		
HYRJA E PARASË SË GATSHME								
8	374.79	324.71	324.71	(50.09)	263	293		
Të hyrat tatimore								
9	428.01	321.95	321.95	(106.06)	298	284		
Të hyrat jo tatimore								
10	-	-	-	-	-	-		
Të hyrat e dedikuara								
11	21.17	21.17	-	-	11	6		
Grantet e përcaktuara të donatorëve								
12	-	-	-	-	-	-		
Tjera								
Gjithsej Pranimet	823.97	667.82	646.66	(156.14)	572	583		
DALJA E PARASË SË GATSHME								
2	5,058.05	5,058.05	5,289.71	-	5,232.50	4,959.25		
Paga dhe shitesa								
3	826.34	846.21	800.00	20	1,725.42	824.64		
Mallra dhe shërbime								
4	188.60	204.96	212.77	16	183.23	140.48		
Shpenzime komunale								
5	300.80	304.19	250.00	3	230.24	215.42		
Transfere dhe subvencione								
6	2,279.83	2,672.98	2,230.13	393	1,654.08	1,971.73		
Shpenzime kapitale								
Rezerva								
7	-	-	-	-	-	-		
Tjerat								
Gjithsej pagesat	8,653.62	9,086.39	8,782.60	433	9,025.47	8,111.52		

Shpalosje:

Shënimi 8:

Në kolonën A janë paraqitur të hyrat tatimore të realizuara gjithësej 374,793.05€ ndersa ne kolonen B kemi paraqitur te hyrat sipas planifikimeve fillestare. Përkundër tejkalimeve ne te hyrat direkte prej 50,088.05€, në mungesë të funksionimit të Asamblesë Komunale si rezultat i organizimit të Zgjedhjeve Lokale nga KQZ, për arsye se nuk janë zhvilluar seanca që nga muaji shtatorë i vitit 2021, ne nuk kemi mundur të rishikojmë planin e të hyrave .

Shënimi 9:

Në kolonën A janë paraqitur të hyrat jo tatimore të realizuara në shumë prej 428,006.15€, ndersa shuma prej 167,106.72€ i takon të hyrave indirekte te Agjensioneve tjera si: Gjykatat, Policia dhe AGJPK, të cilat janë alokuar nga Thesari në llogarinë e komunës. Poashtu, edhe ketu ne kolonen B kemi paraqitur te hyrat sipas planifikimeve fillestare. Përkundër tejkalimeve ne te hyrat direkte prej 106,056.15€, ku në mungesë të funksionimit të Asamblesë Komunale si rezultat i organizimit te Zgjedhjeve Lokale nga KQZ, për arsye se nuk janë zhvilluar seanca që nga muaji shtatorë i vitit 2021, ne nuk kemi mundur të rishikojmë planin e të hyrave .

Neni 15

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Shënimi 1

1. Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Entitet i sektorit publik komuna e Kaçanikut ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPF të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Komuna e Kaçanikut me Kod Organizativ (KO - 652), gjatë vitit raportues 2021 aktivitetet buxhetore i ka realizuar duke u mbështetur në legjislacionin e përgjithshëm nga fushëveprimtaria e financave të sektorit publik. Janë zbatuar dhe zhvilluar të gjitha procedurat dhe fazat e përcaktuara në përgatitjen dhe miratimin e Buxhetit të komunës për vitin 2019 dhe përmabjtjesë me përpikëri të kalendarit kohor deri në fazën e fundit të aprovimit në Kuvendin e Komunës. Po ashtu, gjatë vitit 2021, rëndësi iu është kushtuar harmonizimit dhe rregullimeve në ndarjet e reja buxhetore dhe transfereve të mjeteve brenda Organizatës buxhetore përmes lëvizjës së mjeteve nga një program apo nënprogram në program-nënprogram tjetër buxhetor, pastaj nga një kategori në kategorinë tjetër të shpenzimeve si dhe rialokimit-ridestinitimit të mjeteve brenda të njejtës kategori të shpenzimeve. Ndërsa Rishikimi Buxhetor i rregullt nuk është aplikuar përshkak të mos dergimit të instruksioneve dhe lejitimit të këtij procesi për nivelin lokal nga Ministria e Financave. Është zbatuar legjislacioni në fuqi si, Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, (LMFPF) dhe ndryshimet e bëra në LMFPF-së, Ligji i Financave të Pushtetit Lokal (LFPL), Ligji i Buxhetit për vitin 2021 dhe të gjitha aktet nën-ligjore të

cilat rregullojnë këtë lëmi. Po ashtu, është zbatuar në mënyrë konsekuente Plani kontabël, ashtu siç është konceptuar nga ana e Ministrisë së Financave.

1.1 Pagesat nga palët e treta

Në zbatim të SNKSP 2017 pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.3 Shumat raportuese

Shumat raportuese nga neni:

13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€),

16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

1.4 Valuta raportuese

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€),

1.5 Data e autorizimit

Autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës për Pasqyrat Financiare nga Zyrtari Kryesore Administrativë dhe Zyrtari Kryesore Financiar.

Neni 14.6

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Kategoria e ndarjes	Ndryshimet e autorizuara nga LMFPF									
	Buxheti Fillestar (Ligji i Buxhetit)	Ndryshimi I Vendi 1a/2021 MFPT	Ndryshimi II-Vendi 728-1/2021 MFPT	Ndryshimi III	Ndryshimi IV. Tejkalmi I HVK	Barzja e bilanceve nga 2020	Grantet e percaktuara te donatoreve	Burime tjera te financimit	Buxheti përfundimtar SIMFK	Ndryshimet e buxhetit fillestar
